

Informacion praktik


Të dhënat e kontaktit

Kind en Gezin

Hallepoortlaan 27
1060 Brussel
Kind en Gezin-Lijn: 078 150 100
www.kindengezin.be
Emailen kan via de
contactpagina op onze website



Verantwoordelijke uitgever Kind en Gezin, Katrien Verhegge, administrateur-generaal – Vlaams Agentschap – 05/2015



Dit is de vertaling Albanees van 'Prenatale steunpunt' en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst 'Prenatale steunpunt'.

Jeni shtatzënë?

Kind & Gezin

“Kind en Gezin” (Fëmija dhe Familja) ofrojnë shumë informacione për prindërit e rinj. Kjo na lejon të punojmë së bashku për të ndërtuar një të ardhme për çdo fëmijë.

Lexoni më shumë në www.kindengezin.be.

Për më tepër, “Kind en Gezin” dëshiron të ofrojë shërbime të fokusuara për prindërit e rinj që kanë akses të kufizuar në kujdesin shëndetësor për arsye administrative, personale, financiare ose të tjera.

Funksionimi

“Kind en Gezin” synon të ofrojë një pikë pritjeje me qasje të lehtë për të gjithë ata që e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë. Shërbimet tona falas para lindjes përbëhen nga vizitat në shtëpi/ose vizitat në një qendër mbështetëse të paralindjes. Gjatë takimit fillestar, ne përpiqemi të identifikojmë çdo nevojë që mund të adresohet nga shërbimet “Kind en Gezin”.

Nëse kemi një qendër për mbështetjen e paralindjes në zonën tuaj, ne mund t’ua japim udhëzimet aty.

Kontakti juaj i parë në qendrën e mbështetjes së paralindjes do të jetë me një nga vullnetarët tanë. Më pas do të referoheni te një infermiere dhe/ose mjek. Ju po ashtu mund të takoheni me një punonjëse sociale për familjen që është trajnuar të kuptojë situatën tuaj të veçantë.

Një qendër për mbështetjen e paralindjes mund të ofrojë mbështetjen e mëposhtme:

- takimi fillestar
- vizitë në shtëpi në javën e 8-të të shtatzënisë tuaj
- konsultë në javën e 12-të të shtatzënisë tuaj
- konsultë në javën e 16-të të shtatzënisë tuaj
- konsultë në javën e 20-të të shtatzënisë tuaj
- konsultë në javën e 24-t të shtatzënisë tuaj
- konsultë në javën e 28-të të shtatzënisë tuaj
- vizitë në shtëpi në javën e 32-të të shtatzënisë tuaj
- konsultë në javën e 36-të të shtatzënisë tuaj
- konsultë rreth 6 javë pasi të ketë lindur foshnja

Shërbimet ofrohen sipas nevojave, ndaj sasia e mbështetjes së dhënë mund të ndryshojë nga njëri rast në tjetrin.

Nëse dhe kur të nevojitet ndihmë mjekësore (shtesë), (si për shembull një kontroll me ultratinguj ose kujdes dhe mbështetje gjatë lindjes së fëmijës), ne do t’ju referojmë te ofruet të tjerë të kujdesit.

Nëse nuk kemi një qendër të mbështetjes së paralindjes në zonën tuaj, do të merrni mbështetje në formën e vizitave në shtëpi nga një infermiere rajonale (dhe mundësisht një punonjëse sociale për familjen).

“Kind en Gezin” po ashtu luan një rol edhe pasi lind foshnja. Personeli ynë ndihmon ju dhe foshnjën tuaj dhe ne do të vazhdojmë të jemi të përfshirë derisa fëmija të mbushë moshën 3 vjeç. Shërbimet tona janë falas.